

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **204-26-5325-2-3-6**

Sa i përket tenderit për **Shërbimet e autolarjes për nevojat e MINTI**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	EDA CARS AUTOMOBILE L.L.C.
NUI	812249250
Adresa	Lorenc Antoni, pn.
Vendi	Prishtine
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Teuta Thaci
Adresa elektronike	carwash.eda01@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	03.09.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Shërbimet e autolarjes për nevojat e MINTI

Autoriteti Kontraktues: Ministria e Industrisë. Ndermarresise. Tregtise dhe Inovacionit (MINT').

Procedura: Kuotim i cmimit.

Dosja e Tenderit mban datën 02.07.2026.

Afati dorezimit dhe hapja elektronike e tendereve: 09.07.2026, ora 14:00

Kriteri i dhenies: Tenderi i pergjegjshem me cnimin me te ulet.

Me date 24.08.2026 eshte publikuar Formulari B58

Kerkesa per rishqyrtim pran AK e parashtuar me date 25.08.2026

Pergjigjja nga AK ndaj kerkeses tone per rishqyrtim me date 26.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kerkesa per rishqyrtim prane AK e parashtuar me date 25.08.2026

Pergjigjja nga AK ndaj kerkeses tone per rishqyrtim me date 26.08.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

LPP:

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tendereve

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

RRPP:

Neni 40.1, 40.2, 40.6, 40.8, 40.12 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me datë 24.08.2026 kemi pranuar përmes Platformës Elektronike E-Prokurimi njoftimin mbi vendimin e AK si dhe letrën standarde për tenderuesin e eliminuar dhe njoftimin për rekomandim për kontratë OE GMM Group SH.P.K.

Në këtë aktivitet të prokurimit janë dorëzuar gjithsej tri (3) oferta. Sipas procesverbalit të hapjes së ofertave, oferta jone ka qenë me çmimin më të ulët në krahasim me ofertat e tjera pjesëmarrëse, ndërsa AK ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik me çmimin më të lartë.

Konform nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar ("LPP"), Ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, e cila është refuzuar si e pabazuar. AK në përgjigjen e saj ndaj kërkesës për rishqyrtim, ka ndryshuar tërësisht arsyen fillestare të eliminimit, siç shpjegohet në detaje në Pretendimin II më poshtë.

Duke qenë se pakënaqur me këtë vendim, brenda afateve dhe konform LPP-se NENIT 109, parashtrojme këtë ankesë pranë OSHP-së, për arsyet:

PRETENDIMI 1: Eliminimi i padrejtë i ofertës tone - dokumenti i kërkuar ka qenë pjesë e ofertës

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar (Formulari B42), AK ka arsyetuar eliminimin e ofertës tone si vijon:

Në kuadër të ofertës tuaj nuk keni ofruar listën e kontratave ashtu siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, mirëpo keni ofruar një kontratë për qiramarrje.

Ky konstatim është faktikisht i pasaktë, për arsyet si në vijim:

Seksioni III.4 i dosjes së tenderit kërkon listën e kontratave për shërbime të natyrës së ngjashme, me vlerë së paku 7,000.00 €, gjatë tri viteve të fundit, listë që duhet të jetë origjinale, e vulosur dhe e nënshkruar, e shoqëruar me kopjet e referencave përkatëse.

Ne kemi dorëzuar në ofertën listën e kontratave, të shoqëruar me dokumentacionin mbështetës të plotë (kontratat dhe referencat përkatëse) në vlerë totale prej 13,012.84 Euro, e cila e tejkalon pragun minimal prej 7,000.00 Euro të kërkuar në dosjen e tenderit.

Formulari B66 (Konfirmimi i dorëzimit të tenderit), i gjeneruar automatikisht nga vetë sistemi E-Prokurimi më datë 09.07.2026 për tenderin me kod EDA0107, e evidenton shprehimisht, në faqen 1, tek "Lista e dokumenteve të tenderit", dokumentin nr. 5 "5.0. Lista e Referencave.pdf". Ky dokument gjenerohet automatikisht nga sistemi elektronik i prokurimit, dhe përbën provë objektive e të pakontestueshme se dokumenti në fjalë ka qenë pjesë e ofertës së dorëzuar.

Rrjedhimisht, konstatimi i komisionit vlerësues se "nuk keni ofruar listën e kontratave" bie ndesh drejtpërdrejt me të dhënat e vetë sistemit elektronik të prokurimit dhe përbën një vlerësim faktikisht të gabuar. Ky veprim është në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve) dhe nenin 40, paragrafët 40.1, 40.2, 40.6, 40.8 dhe 40.12 të Rregullores për Prokurimin Publik (RRPP), të cilat kërkojnë që vlerësimi i tenderëve të bazohet në përmbajtjen faktike të ofertës së dorëzuar.

Vlen poashtu të ceket që vlera prej 13,012.84 € është vlerë e realizuar deri në datën 01.07.2026, ku vlera e kontratave është realisht edhe më e lartë. Referojuni kontratës së bashkëngjitur me Autoritetin Kontraktues ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVES.

PRETENDIMI 2: Ndryshimi i arsyes së eliminimit në vendimin ndaj kërkesës për rishqyrtimit

Ky pretendim përbën shkeljen më të rëndë procedurale të këtij rasti dhe kërkon vëmendje të veçantë nga paneli shqyrtues i OSHP-së.

Në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim, AK nuk ka mbrojtur arsyen fillestare të eliminimit (mungesa e listës së referencave), por e ka zëvendësuar plotësisht atë me një arsyetim të ri:

„Në kuadër të ofertës tuaj ju keni sjellë listën e kontratave, mirëpo lista e prezantuar nuk arrin vlerën e kërkuar sipas njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit; njëkohësisht kontratat e prezantuara duhet të jenë kontrata të përfunduara dhe jo ato që janë në vazhdim.“

Ky ndryshim i plotë i arsyes së eliminimit, brenda të njëjtës procedurë administrative, ngre dy probleme thelbësore:

Së pari, vetë fakti që AK braktisi arsyen fillestare tregon se e pranoi si të bazuar pretendimin tone, përndryshe do ta kishte mbrojtur në përgjigjen e saj. Në vend të kësaj, AK përpiqet të gjejë retroaktivisht një arsye tjetër për të justifikuar një rezultat tashmë të vendosur.

Së dyti, arsyeja e re është edhe vetë e pambështetur në dosjen e tenderit. Seksioni III.4 kërkon vetëm "listë të kontratave për shërbime të natyrës së ngjashme, me vlerë së paku 7,000.00 Euro gjatë tri viteve të fundit" pa kërkuar askund që kontratat të jenë "të përfunduara formalisht" e jo "në vazhdim". Kjo kërkesë shtesë nuk gjendet në dosjen e tenderit dhe përbën krijim të një kriteri eliminues që nuk ishte percaktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, çka bie ndesh me parimin e transparencës dhe të barazisë së trajtimit (neni 7 i LPP-së) dhe me RRPP, NENIN 40.12 *Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.*

PRETENDIMI 3: Kërkesa për rishqyrtim ka qenë brenda afatit ligjor

AK ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim, ndër të tjera, edhe me arsyetimin se ajo qenka parashtruar jashtë afatit të paraparë me LPP.

Ky konstatim është faktikisht i pasaktë pasi që:

- **Data e njoftimit të vendimit të AK-së: 24.08.2026**
- **Data e parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim nga Ankuesi: 25.08.2026 (dita pasuese)**

Kërkesa është parashtruar brenda vetëm një (1) dite nga marrja e njoftimit, pra në mënyrë

të padiskutueshme brenda afatit ligjor prej pese (5) ditësh të percaktuar me nenin 108/A të LPP-së për parashtrimin e kërkesës për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës me arsyetimin se është e pasafatshme është, rrjedhimisht, i pambështetur në fakte dhe përbën një shkelje procedurale shtesë që dëshmon qasjen e njëanshme të AK-së ndaj neve si ofertues.

PRETENDIMI 4: Trajtim i pabarabartë në përdorimin e sqarimeve

Procesverbali i hapjes së ofertave dëshmon renditjen e çmimeve si vijon: Eda cars automobile L.L.C- 3,930.00 €, çmimi më i ulët; Grupi i Operatorëve Ekonomikë Air Group SH.P.K. & KIGA SH.P.K. -3,980.00 €, çmimi i dytë më i ulët.

Në letrën standarde (Formulari B42) drejtuar grupit Air Group SHPK & KIGA SHPK, AK deklaroi: „Edhe pas kërkesave për sqarime shtesë ju nuk jeni përgjigjur sipas kërkesës së AK-MINTI brenda afatit të caktuar ashtu siç është e paraparë me LPP.“

Kjo dëshmon se AK ka përdorur mekanizmin e kërkesës për sqarim shtesë ndaj ofertuesit të dytë sipas çmimit, ndërsa ndaj neve si ofertues me çmimin më të ulët nuk është drejtuar asnjë kërkesë e ngjashme lidhur me dokumentin që AK pretendonte se mungonte, edhe pse ai dokument, siç u dëshmua në Pretendimin 1, ka qenë realisht pjesë e ofertës.

Një kërkesë e thjeshtë për sqarim, e barasvlershme me atë të dërguar grupit tjetër, do ta kishte zgjidhur çështjen menjëherë, duke konfirmuar se "5.0. Lista e Referencave.pdf" ishte pjesë e ofertës. Trajtimi selektiv gjate sqarimeve i aplikuar për njërin ofertues e jo për tjetrin, në rrethana krahasueshme përbën shkelje të drejtpërdrejtë të parimit të barazisë që percaktohet në nenin 7 të LPP-së. Eda cars automobile L.L.C nuk kërkon trajtim favorizues apo lejim të një dokumenti të ri, por vetëm trajtim të barabartë dhe shqyrtim korrekt të dokumenteve tashmë ekzistuese në ofertën e dorëzuar.

Si përfundim Autoriteti Kontraktues ne kundërshtim me legjislacionin dhe rregulloret ne fuqi ka marr vendim duke propozuar për kontrate OE GMM Group SH.P.K, duke na eliminuar neve si ofertues te pergjegjshem dhe me cmimin me te lire te ofruar ne kete aktivitet te prokurimit.

Ky vendim përbën shkelje të qartë të dispozitave ligjore të mëposhtme:

- Neni 1 i LPP, i cili përcakton se fondet publike duhet të shfrytëzohen në mënyrë sa më efikase, transparente dhe ekonomike. Eliminimi i nje OE te pergjegjshem me cmimin me te lire te ofruar ne kete aktivitet te prokurimit bie ndesh me kete dispozite ligjore.

- Neni 6 i LPP-se Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, i cili përcakton se të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike. Ne rastin konkret eliminimi jone edhe pse kemi plotësuar te gjitha kriteret dhe kerkesat e dosjes se tenderit dhe rrjedhimisht AK duke shperblyer me kontrate OE me cmimin me te larte bie ndesh me kete dispozite.

- Neni 7 i LPP, që ka për qëllim sigurimin e trajtimit të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë. Në rastin konkret, ashtu sic e kemi sqaruar ne pretendimin 4 AK ka pas qasje diskriminuese ne rastin e kerkesave per sqarime.

- Neni 59 i LPP, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, paragrafi 4-Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Ne rastin konkret Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar Eda cars automobile L.L.C edhe pse plotëson ne teresi kriteret dhe kerkesat e dosjes se tenderit.

- Neni 72 i LPP, Dokumentacioni dhe informacioni shtesë- Ne rastin konkret AK ka pas mundësi qe te drejtohet me kerkese per sqarim dhe do te ishte evidentuar dokumenti qe AK kishte pretenduar se mungonte.

- Neni 40 paragrafi 6 i Rregullores per Prokurim Publik, citoj: 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.- Ne rastin konkret oferta jone eshte plotësisht konform kerkesave te dosjes se tenderit.

Përmbledhje dhe Kërkesë Përfundimtare

Bazuar në të gjitha arsyet dhe bazat ligjore të paraqitura më sipër, konsiderojmë se vendimi i Autoritetin Kontraktues është marrë ne kundërshtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (i ndryshuar dhe plotësuar), si dhe të rregulloreve dhe udhëzuesit për Prokurim Publik.

Për këto arsye, përmes kësaj ankese kërkojmë nga OSHP:

- Të aprovojë këtë ankese si te bazuar;
- Të anulojë njoftimin mbi vendimin e AK dhe te kthej aktivitetin e prokurimit në fjale në rivlerësim dhe,
- Te detyroje AK të bëjë rivlerësimin e ofertave në përputhje me LPP-në, rregulloret në fuqi, dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëm të drejtpërdrejtë financiar për kompaninë tonë, për shkak të humbjes së një kontrate të konsiderueshme dhe kostove të investuara në përgatitjen e ofertës. Po ashtu, cenon konkurrencën e ndershme dhe krijon precedent negativ për tenderët e ardhshëm.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*